

Agjencia e Trajtimit të Kredive, njofton se kërkon të marrë me qira ambiente për ushtrimin e veprimtarisë administrative, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Sipërfaqen në “m²” të domosdoshme të ambienteve për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ISHMT-së (të ndërtesës dhe sipërfaqes funksionale për parkim) nga **350 – 450 m²** për zyra administrative, në të cilat do të akomodohet personeli i ATK-së dhe sipërfaqe të mjaftueshme për vendparkimi jo më pak se **3 automjete**.
2. Specifikat e nevojshme të ambienteve që kërkohet të merren me qira, bazuar në funksionalitetet sipas distancës/largësinë nga qendra e Tiranës :

Kriteret	Pikët
Çmimi Lekë/m²	30
Afati i akomodimit jo me vonë se 14 ditë kalendarike nga lidhja e kontratës, ku ambienti të jetë i përshtatur në hapësira sipas nevojave të institucionit qiramarrës.	10
Akomodimi për çdo post pune: -porta interneti -priza energjie	10
Sistem ngrohje/ftohje funksional	10
Distanca sa më afër qendrës së Tiranës / Brenda Unazës së Vogël	30
Sistem i pavarur për furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike dhe ujit	10

Dokumentacioni që do të paraqesin ofertuesit të ketë në përbërje:

- aktin e pronësisë/disponimit të pronës të rinovuar tremujorin e fundit;
- të jetë i pajisur me NIPT/NUIS dhe certifikatë regjistrimi;
- ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- vërtetim që mos të ketë detyrime të maturuara nga OSHE, UKT etj.
- vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

- aktin administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore dhe/ose aktin e konstatimit që rezulton i banueshëm nga Instituti i Ndërtimit.
- Planvendosje të objektit dhe planimetri .

Afati i paraqitjes së ofertave pranë zyrave të Inspektoratit Agjencia e Trajtimit të Kredive me adresë Rruga "Dora D'Istria", Ndërtesa 22, Hyrja 1, Kodi 3771821017 do të jetë data 29.06.2021 ora 10:00.